



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.10.2023, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – sekretare e Sekretariatit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i kërkesës të një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për “Marrjen e masës disiplinore”.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka – sekretare e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Klevis Xhoxhi – anëtar i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Aurora Mara – anëtare e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Mungojnë:

Saimir Korreshi – anëtar i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Bledjon Nallbati – anëtar i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Të pranishëm nga shërbimet e Kuvendit:

Merita Qato – drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Legjislativ

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka – Kolegë, kemi thirrur një mbledhje të menjëhershme me kërkesën e nënkryetares së Kuvendit, zonjës Felaj, si dhe kërkesës të një grupi deputetësh të Partisë Socialiste në lidhje me ngjarjet e ndodhura sot.

“Të gjendur përballë një situatë të paprecedentë dhe jonormale, për bllokimin e fillimit të seancës plenare të datës 19.10.2023, ku deputetët e opozitës, në thyerje të rëndë të Rregullores së Kuvendit dhe të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, bllokuan hyrjen e deputetëve të Grupit Parlamentar të PS-së dhe hoqën kartat e tyre nga pajisjet elektronike të votimit, duke bllokuar më pas vendet ku ulet Kryetarja e Kuvendit dhe kabineti qeveritar, si dhe portat hyrëse të tyre duke vendosur karrige...”

Kolegë, nuk po vazhdoj ta lexoj kërkesën, pasi ju e kenë.

Mbledhja e Sekretariatit është thirrur rregullisht, sipas Rregullores së Kuvendit për përcaktimin e rregullave proceduralë të funksionimit të sekretariateve të Kuvendit të Shqipërisë. Ne e njoftuam këtë mbledhje në mënyrë të menjëhershme dhe kuorumi i nevojshëm për vijimësinë e mbledhjes është i pranishëm.

Ngjarja është e rëndë, është e papranueshme, është zaptim, në fakt, i foltores së Kuvendit, është zaptim i sallës së seancës plenare dhe është një situatë shumë e papranueshme dhe e sikletshme, të them të drejtën. Asnjë nga ne, si anëtarë të këtij Sekretariati, nuk ndihet komod kur shqyrton kërkesa për marrjen e masave disiplinore ndaj kolegëve të opozitës, të cilët, në fakt, e kanë bërë si metodë përsëritëse këtë lloj mënyrë të vepruarit të papranueshme me Rregulloren, me Kodin e Etikës dhe me çdo parim të parlamentarizmit.

Lista për të cilët kërkohet përjashtimi përbëhet nga 27 deputetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lista përbëhet nga 26 deputetë, pasi është shkruar dy herë i njëjti emër, të cilët janë: Sali Berisha, Flamur Noka, Albana Vokshi, Xhelal Mziu, Gazment Bardhi, Bledion Nallbati, Edmond Spaho, Saimir Korreshi, Lindita Metaliaj, Ramadan Likaj, Luan Baçi, Lifter Gështenja, Ina Zhupa, Helidon Bushati, Isuf Çelaj, Asllan Dogjani, Bujar Leskaj, Lodovik Hasani, Tritan Shehu, Greta Bardeli, Dhurata Çupi, Sorina Kote, Kastriot Piroli, Kasëm Mahmutaj, Tomor Alizoti dhe Qani Xhafaj.

Në fakt, ne kemi edhe pamjet e videos.

Po, zonja Merita.

Merita Qato – Janë pamjet e videos së orës 10:00, ku shihet momenti kur duhej të fillonte seanca plenare dhe pamundësia e Kryetares së Kuvendit, që të fillonte të ushtronte detyrën e saj për fillimin e seancës. Pamjet filmike janë vënë në dispozicion nga shërbimit i IT-së, të cilat edhe ju i keni në dispozicion.

Klotilda Bushka – Kolegë, çfarë mendimi keni?

Zoti Xhoxhi, zonja Mara.

Klevis Xhoxhi – Kryetare, të gjithë ishim të vetëdijshëm për të gjithë këtë skenë. U thirrëm sot në orën 10:00 për seancën dhe nuk u lejuam të zhvillonim një seancë normale, pasi deputetët e opozitës e bllokuan sallën, duke zaptuar të gjithë stolat, si dhe duke hequr kartat e deputetëve. Kështu që unë mendoj që ne, patjetër, duhet të marrim masa për të gjithë këtë sjelle.

Klotilda Bushka – Po, zonja Mara.

Aurora Mara – Nuk kam asgjë për të shtuar, jam dakord.

Klotilda Bushka – Në fakt, bëhet fjalë për veprime që, nëse do të ecnim me parimin e proporcionit, është e vështirë t'i ndash, pasi situata është e paprecedentë. Jemi shumë të keqardhur dhe kushdo që do të ishte në vendin tonë si Sekretariat, nuk do të donte të ishte para një situatë të tillë, por Rregulloren e kemi miratuar të gjithë së bashku dhe duhet t'i bindemi njëllë asaj. Kur nuk veprojmë sipas Rregullores, sigurisht, kemi marrë përsipër të vuajmë edhe sanksionet e saj.

Edhe unë, gjithashtu, mendoj si ju, kolegë, kështu që në këto kushte e pranojmë kërkesën për marrjen e masës disiplinore, duke qenë se është bërë edhe paralajmërimi nga ana e nënkryetares së Kuvendit, në cilësinë e kryesueses së seancës, e cila më pas kërkoi mbledhjen urgjente të Sekretariatit. Veprimet janë të rënda dhe duke uruar që t'i rikthem logjikës dhe të kthehem në shinat e parlamentarizmit, do ta pranojmë këtë kërkesë, duke u dhënë deputetëve përjashtimin maksimal me 10 ditë pune. Duke qenë se sot është dita kur ka ndodhur shkelja, masa duhet të fillojë nga dita e nesërme.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Një sekondë!

Po, zonja Qato

Merita Qato – Në mbledhjen e mëparshme pati një problem, sepse, përveç përjashtimit 10 ditë, ka qenë edhe ndalimi i hyrjes në Kryesinë e Kuvendit dhe në seancën plenare. Domethënë, këta deputetë janë të përjashtuar të marrin pjesë në çdo veprimtari parlamentare. Herën e kaluar punonjësit e Gardës kanë hasur probleme me deputetët, kështu që te pjesa e vendimmarrjes duhet shtuar edhe kjo.

Klotilda Bushka – Zonja Merita, sipas Rregullores ndalohet pjesëmarrja e deputetëve në komisionet parlamentare dhe në seancën plenare. Kështu që le të zbatohet Rregullorja. Ne këtë gjë nuk kemi pse ta saktësojmë në vendim, pasi ajo është e zbatueshme nga Rregullorja e Kuvendit.

Kolegë, a keni ndonjë gjë për të shtuar? A jeni dakord me këtë vendimmarrje? Dakord!

Me unanimitet miratohet.

Mbledhja mbyllet.

Uroj të mos mblidhemi më për çështje të tilla.

Le t'i thërrasin logjikës dhe t'u kthehen shinave normale të punës të gjithë kolegët!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA